




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME
Zyra e kryetarit/Kancelarija predsednika/Major's office



Data/Datum/Date:	22.04.2025
Nr./Br./No	02/ 445
Për/Za/To:	z. Adnan Ademi, kryesues i Kuvendit të Komunës Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Shtimes
Nga/Od/From:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim-vendim për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale "Ekosistemi" Sh.A. – Shtime

Bazuar në nenin 12.2, shkronja (d), nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe duke u mbështetur në nenin 5 paragrafi 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, sipas dispozitave të Statutit të Komunës së Shtimes si dhe në pajtim me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ekosistemi" Sh.A., në pronësi të plotë të Komunës së Shtimes, propozohet që Kuvendi i Komunës të shqyrtojë dhe miratojë këtë Propozim-Vendim për votimin e dy anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike "Ekosistemi" Sh. A, siç përcaktohet në nenin 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike.

Duke pasur parasysh rëndësinë që ka përfaqësimi i interesit të Komunës në kuadër të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ekosistemi" Sh.A., dhe nevojën që ky përfaqësim të jetë institucional, i përgjegjshëm dhe i koordinuar, është i domosdoshëm themelimi i Komisionit Komunal të Aksionarëve. Ky Komision do të përbëhet nga tre anëtarë, ku sipas Ligjit Nr. 03L-087 për Ndërmarrjet Publike një anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës ndërkaq dy anëtarë zgjedhen nga Kuvendi Komunal. Anëtarët e Komisionit Komunal të Ndërmarrjes do të kenë për detyrë të përfaqësojnë interesat e Komunës në Asamblenë e Aksionarëve dhe të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse që ndërlidhen me funksionimin dhe drejtimin e kësaj ndërmarrjeje.

Emrat e anëtarëve të propozuar për NPL "Ekosistemi" Sh. A:

1. _____ - anëtar nga Kuvendi
2. _____ - anëtar nga Kuvendi
3. _____ - anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës

Përzgjedhja e anëtarëve bëhet në mënyrë që të sigurohet profesionalizëm, transparencë dhe mbrojtje ndaj interesave publike si dhe në përputhje me dispozitën e nenit 8.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike ata obligohen që në baza të rregullta vjetore ta njoftojnë Kuvendin Komunal përmes raporteve që pasqyrojnë performancën dhe gjendjen në Ndërmarrje Publike.

Mandati i Komisionit do të jetë 3-vjeçar.

Për realizimin e këtij Vendimi pas miratimit do të angazhohen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse, ndërsa dokumentacioni dhe procedurat përcjellëse do të harmonizohen me udhëzimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.